

Shejkh  
Ibrahim ibn Amur er-Ruhejli

# *Këshillë*

*në lidhje me çfarë duhet të merret në  
konsideratë kur ndodhin mosmarrëveshje  
dhe rregullat e bojkotimit dhe të  
kundërpërgjigjes ndaj gabimitarit*

Tiranë 2011

# *Këshillë*

*Titulli i origjinalit:*

**En-Nasiha fi ma jexhibu mura'atuhu indel hilaf, ue dauabitu hexhril muhalifi, ue redi alejhi.**

*Titulli në shqip:*

**Këshillë në lidhje me çfarë duhet të merret në konsideratë kur ndodhin mosmarrëveshje dhe rregullat e bojkotimit dhe të kundërpërgjigjes ndaj gabimtarit.**

*Autori:* **Shejkh Ibrahim ibn Amir er-Ruhejli**

*Përktheu nga arabishtja:* **Ylli Rama**

*Recensoi:* **Shuajb Rexha**

*Redaktor gjuhësor:* **Sashenka Jaupi**

*Faqosja dhe kopertina:* **Rajan Alliu**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!**

### **Parathënia e botimit të parë**

**F**alënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botërave, paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij besnik, mbi familjen e tij dhe shokët e tij të mirë e të pastër.

Më pas:

Nisa të shkruaj këtë broshurë të shkurtër me titull “**Këshillë rinisë**” në fund të muajit të bereqetshëm të Ramazanit të vitit 1424 sipas hixhretit (2003) dhe

e mbarova atë më datën tetë të muajit Sheual të të njëjtit vit.

Pasi e printova këtë broshurë, ia dërgova disa prej dijetarëve dhe kolegëve tanë të nderuar, të cilët shfaqin interes për thirrjen (davetin) dhe orientimin e rinisë. Ata e pëlqyen dhe e vlerësuan përmbajtjen e kësaj broshure si temë akademike; kështu që ua shpërndava disa nxënësve të dijes, në mënyrë që ata ta shpërndanin brenda shtetit tonë, apo edhe jashtë tij, ashtu siç ishte, si dorëshkrim. Më pas, më njoftuan se ishin shpërndarë mijëra kopje prej saj në disa shtete.

Pak kohë më vonë, pati një shtim të interesimit për këtë broshurë, nga individë që nuk u kishte rënë ende në dorë ndonjë kopje, ndaj vendosa që ta botoja, duke shpresuar që nga kjo të përfitojnë të gjithë dhe të jetë e mundshme për të gjithë.

Ky është dhe botimi i saj i parë me një shtesë, me temën **“Pika e gjashtë, e cila ka të bëjë me qëllimet e bojkotimit”**. E shtova këtë pjesë në tekstin e

## *Shejkh Ibrahim Er-Ruhejli*

broshurës, duke parë nevojën e madhe për kujdesin që duhet treguar lidhur me këtë pikë. Po ashtu, kam përmirësuar edhe disa detaje në disa fjali, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e të shprehurit dhe me termat.

E pashë të arsyeshme që t'i vendos një titull, me qëllim që të nxjerrë në pah mesazhin që përmban kjo broshurë, por, njëkohësisht duke ruajtur edhe titullin origjinal, e për këtë arsye e titullova:

**“Këshillë në lidhje me çfarë duhet të merret në konsideratë kur ndodhin mosmarrëveshje dhe rregullat e bojkotimit dhe të kundërpërgjigjes ndaj gabimtarit”.**

E lusim Allahun që ta pranojë këtë punë, si dhe ta bëjë atë të dobishme, të jetë ndihmë për temën që trajton, me të vërtetë Ai është Dëgjues dhe i përgjigjet lutjeve.

***Shejkh Ibrahim ibn Amir Er-Ruhejli***

### **Parathënie**

**F**alënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botërave, paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, mbi familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij.

Kjo broshurë është një këshillë për rininë që pason sunetin dhe xhematin, si obligim për të dhënë kontributin tonë në këshillimin e muslimanëve, po ashtu shërben edhe si bashkim mes Ehli Sunetit, për të cilën kanë ardhur edhe argumentet që na nxisin për diçka të tillë.

Shkak për shkrimin e kësaj broshure është bërë gjendja që përjetojnë shumë prej të rinjve selefij në shumë prej vendeve islame, si edhe në vendet joislame, në të cilat jetojnë një pakicë e muslimanëve. Kjo gjendje është pasojë e mosmarrëveshjeve në disa çështje akademike dhe qëndrimi që mbahet nga disa kundërshtarë, e si pasojë ndodhi përçarja dhe bojkoti, deri sa kaloi në armiqësi e padrejtësi midis pasuesve të sunetit.

## *Shejkh Ibrahim Er-Ruhejli*

Rrjedhimisht, fitneja u shtua dhe rreziku i saj u përshkallëzua, gjë e cila ndikon në ecurinë e davetit për të pasuar sunetin dhe po ashtu, u bë shkak që t'i ndalojë disa persona që të bashkohen me këtë thirrje, pasi që njerëzit filluan që t'i përgjigjeshin kësaj thirrje në shumë prej vendeve dhe shteteve.

Po e përmbledh këtë këshillë në pikat e mëposhtme, duke e lutur Allahun e Lartësuar që të jem i singërtë dhe ta arrij të vërtetën në fjalë dhe po ashtu ta kthejë këtë broshurë në dobi për të gjithë ata muslimanë që e lexojnë.

**E** para: Prej bazave themelore të fesë është se muslimani duhet të përmirësojë veten e tij dhe të mundohet që ta shpëtojë atë, si dhe të largohet prej gjërave që e shkatërrojnë, përpara se të merret me njerëzit e tjerë, ashtu sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

وَالْعَصْرِ ﴿١﴾ إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُفٍ ﴿٢﴾ خُسْرٍ ﴿٣﴾ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ

وَتَوَّاصُوا بِالْحَقِّ وَتَوَّاصُوا بِالصَّبْرِ ﴿٤﴾

***“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe e këshillojnë njëri-tjetrin për durimin”. (Asr:1-3).***

Allahu i Lartësuar tregon për ata që shpëtojnë nga humbja se vetëm ata janë njerëzit që i përmbushin këto cilësi. E vuri theksin tek besimi dhe puna e mirë te vetja e tyre, para se t’i thërrisnin të tjerët që të këshilloheshin me të vërtetën dhe me durimin. Ky është thelbi për sa i përket kësaj çështjeje.



Allahu i Lartësuar i ka qortuar Beni Israilët (çifutët), për shkak se e kanë kundërshtuar këtë parim bazë, sikurse na tregon Allahu me fjalën e Tij:

أَتَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبِرِّ وَتَنْسَوْنَ أَنْفُسَكُمْ وَأَنْتُمْ تَتْلُونَ الْكِتَابَ أَفَلَا

تَعْقِلُونَ

***“Vallë, a i urdhëroni njerëzit që të bëjnë të mira dhe veten tuaj po e harroni, megjithëse ju i lexoni Shkrimet?! A nuk po arsyetoni?!”*** (Bekare: 44).

Rinia duhet të punojë për përmirësimin e vetes, para se të mendojë për të përmirësuar të tjerët; nëse ata i përmbahen kësaj metode dhe nëse arrijnë që të bashkojnë mes zbatimit të fesë së Allahut te vetja e tyre dhe thirrjes që u drejtojnë të tjerëve, atëherë, ata janë në të vërtetë sipas udhëzimit të Selefëve dhe Allahu do sjellë dobi me ta, si dhe do konsideroheshin thirrës në sunet me fjalët dhe punët e tyre. Pasha Allahun! Kjo është grada më e lartë, e cila nëse i mundësohet dikujt që

ta arrijë, ditën e Gjykimit ai do të jetë nga njerëzit në gradë më të lartë.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَنْ أَحْسَنُ قَوْلًا مِّمَّنْ دَعَا إِلَى اللَّهِ وَعَمِلَ صَالِحًا وَقَالَ إِنِّي مِنَ

الْمُسْلِمِينَ

***“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam musliman.” (Fussilet: 33).***

**E**dyta: Dihet se pasuesit e vërtetë të sunetit janë shëmbëlltyra më e mirë e Islamit si në besim, ashtu edhe në sjellje. Si rrjedhojë e moskuptimit në mënyrë të drejtë, në përgjithësi mendohet se për të qenë pasues i Sunetit ose për të qenë selefi, mjafton që personi të ketë besimin e pastër të Ehli Sunetit, pa i dhënë rëndësi anës së moralit dhe të sjelljes islame, si dhe t’u japë hakun muslimanëve në marrëdhëniet shoqërore midis tyre.

Shejhul Islam Ibn Tejmijeh në fund të librit *Akidetul Wasitijeh*, pasi përmendi bazat e Ehli Sunetit në besim thotë: *“Megjithatë, ata pasi i kanë të gjitha këto baza, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, ashtu sikurse i urdhëron ata Sheriati (Islami) dhe besojnë se kryerja e Haxhit, e Xhihadit, e Xhumave, e Bajrameve bëhet me prijësit, qofshin të mirë, apo mëkatarë të prishur. Gjithashtu i kushtojnë rëndësi namazeve me xhemat, besojnë se duhet që ta këshillojnë umetin, si dhe ta besojnë fjalën e tij, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ku thotë:*

***“Besimtari për besimtarin është si një ndërtesë e vetme, pjesët e së cilës forcojnë njëra-tjetrën”*** dhe ndërthuri gishtërinjtë e tij, si dhe fjalën e tij:

***“Shembulli i besimtarëve në dashurinë mes tyre dhe mëshirën e dhembshurinë që kanë për njëri-tjetrin është si shembulli i një trupi të vetëm, nëse një pjesë e tij rënkon, atëherë i gjithë trupi përjeton ethe dhe pagjumësi”.***

## *Këshillë*

*Gjithashtu, ata urdhërojnë për durim kur bie fatkeqësia, për falënderim kur janë në mirësi dhe për t'u kënaqur me caktimin, qoftë ky edhe i hidhur. Bëjnë thirrje për të shfaqur sjelljet më të mira dhe punët më të mira, si dhe të besojnë fjalën e tij, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të:*

***“Besimtari me besimin më të plotë është ai, i cili ka moralin më të mirë”.***

*Ata e nxisin besimtarin që të mbajë lidhjet me atë, i cili i ka shkëputur lidhjet, t'i japë atij që nuk i ka dhënë, ta falë atë që i ka bërë padrejtësi; urdhërojnë për sjelljen e mirë me prindërit, po ashtu, ata urdhërojnë që të ruhen lidhjet farefisnore, të sillet mirë me komshinjtë, ndalojnë nga mendjemadhësia, nga mburrja, nga arroganca ndaj krijesave, qofshin këto gjëra me të drejtë, apo pa të drejtë. Ata urdhërojnë për moral të lartë dhe i ndalojnë sjelljet e ulëta.*

*Gjithçka që veprojnë ose thonë prej këtyre gjërave, apo gjërave të tjera, e bëjnë duke pasuar Librin e*

Allahut dhe Sunetin; rruga e tyre është feja Islame, me të cilën Allahu dërgoi Muhamedin, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të”. Mbaroi fjala e Ibn Tejmijes, (“Akidetu Uasitijeh”: 129-131).

**F**retre: Prej qëllimeve të mëdha që Islami ka nxitur për to është edhe: udhëzimi i njerëzve në këtë Fe, ashtu sikurse i tha Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, Aliut kur e dërgoi atë në luftën e Hajberit:

***“Nëse Allahu udhëzon nëpërmjet teje qoftë edhe një person të vetëm, është më mirë për ty se sa të posedosh devetë e kuqe”*** (Transmeton Buhariu nr. 4210 dhe Muslimi nr. 2406).

Për këtë arsye, atyre që Allahu ua ka mundësuar udhëzimin në sunet duhet që të mundohen t’i thërrasin edhe të tjerët, të cilët kanë humbur prej tij, apo që kanë neglizhuar në përmbushjen e tij ashtu si duhet, si dhe të përdorin të gjitha mënyrat e mundshme për t’i udhëzuar njerëzit, e për t’i afruar zemrat e tyre tek e vërteta, duke u folur me

butësi, ashtu siç na tregon Allahu i Lartësuar kur i tha Musait dhe Harunit:

أَذْهَبَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَىٰ ﴿٤٣﴾ فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيِّنًا

**“Shkoni tek Faraoni sepse ai e ka tepruar. Dhe flisni me të me fjalë të buta”** (Taha: 43-44).

Allahu urdhëroi që atij njeriu që e ka tepruar t’i flitej me butësi, megjithëse e dinte që ai njeri do të vdiste si mohues, e duke qenë kështu, çfarë mund të thuhet për ata që janë më pak të këqinj se ai, për ata muslimanë që kanë bërë gabime?!

Gjithashtu t’u drejtohesh njerëzve, të cilëve u bën thirrje, me titujt dhe ofiqet që u përshtaten gradave dhe pozitave të tyre, sikundër kemi shembullin e Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, kur i ka shkruar Herakliut duke iu referuar: **“Drejtuar Herakliut, të madhit të romakëve”**, apo sikurse e thërriste Abdullah ibn Ubej ibn Selulin me llagapin Ebul Habab.

Thirrësi duhet të jetë i pajisur me durim, në rastet kur personat që thërrihen tregojnë sjellje të ftohtë, apo të sillen mirë edhe kur ata sillen në mënyrë të padenjë, në mënyrë që të mos tregohen të nxituar në arritjen e fryteve; siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

فَاصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُولُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ وَلَا تَسْتَعْجِلْ لَهُمْ

***“Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ata!(El -Ahkaf: 35).***

***E*** katërta: Nxënësit e dijes, në veçanti ata që janë thirrës, duhet që të bëjnë dallimin ndërmjet mirësjelljes dhe lajkave.

*Mirësjellja* është elementi që kërkohet, i cili ka të bëjë me butësinë në sjellje, sikundër është përmendur edhe në librin **“Lisanul Arab”** (14/255): *“...mirësjellja me njerëzit d.m.th: të jesh i butë me ta, të sillësh mirë dhe t’i durosh ata, në mënyrë që mos të largohen prej teje”*; nga ana tjetër, *lajkatimi*

## Këshillë

është i urryer dhe ka të bëjë me fenë, Allahu i Lartësuar thotë:

وَدُّوا لَوْ تَدَّهِنُ فَيَدَّهِنُونَ ﴿٩﴾

***“Ata dëshirojnë që ti të bësh lëshime, kështu që edhe ata të bëjnë lëshime”.*** (El-Kalem: 9).

Hasen el-Basri ka thënë në komentimin e këtij ajeti: *“Ata kanë dëshirë që të të bëjnë lajka në fenë tënde, në mënyrë që edhe ti t’u bësh lajka në fenë e tyre”* (“Tefsir el-Begauj”: 4/377).

Ai që shfaq mirësjellje tregon butësi në marrëdhënien e tij ndaj të tjerëve, por pa lëshuar gjë prej fesë së tij në mirësjelljen që tregon me njerëzit, ndërsa ai që bën lajka afrohet tek njerëzit, duke lënë mangët diçka prej fesë. I dërguari i Allahut, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ka qenë personi me moralin më të mirë, si dhe më i buti me umetin, kjo përbën pjesën e udhëzimit të tij në butësi dhe në mirësjellje. Në të njëjtën kohë, ai ka qenë njeriu më korrekt në fenë e Allahut, nuk



lëshonte gjë prej fesë, ndaj askujt dhe për askënd, kushdo që të ishte dhe kjo gjë përfaqëson forcën e qëndrueshmërisë së tij në fe, e cila bie ndesh me lajkatimin.

Për këtë arsye nxënësit e dijes duhet që ta bëjnë dallimin mes tyre, sepse ka disa prej njerëzve që mendojnë se të jesh i butë me njerëzit është dobësi në fe dhe quhesh i lëkundur, ndërsa disa të tjerë mendojnë se prej cilësive, si mirësjellja dhe butësia, është që ta pranosh të kotën prej njerëzve, si dhe të heshtësh ndaj gabimit. Që të dyja grupet e kanë gabim, janë larg së vërtetës, prandaj na nevojitet që të kemi kujdes në këtë pikë, sepse rrëshqitja në të është e rrezikshme dhe prej saj ruhet vetëm individi, të cilin Allahu e ka udhëzuar dhe i jep sukses.

**E**pesta: Ai që i thërret njerëzit, mund të përdorë dy mënyra të ligjshme, për të cilat kanë ardhur edhe argumentet.

**Mënyra e parë:** duke ndjekur rrugën e afrimit, të inkurajimit dhe të nxitjes për punë të mira.

**Mënyra e dytë:** duke ndjekur rrugën e bojkotimit dhe tërheqjes së vërejtjes.

Ai që e përgjithëson përdorimin e njërës prej këtyre dy mënyrave me çdo person gabon. Përkundrazi, me njeriun që gabon, ai duhet të ndjekë atë rrugë që shpreson se është më e dobishme për të, më afër pranimit të së vërtetës prej tij dhe më afër përmirësimit të tij, kjo është rruga që duhet të ndiqet me të. Nëse bojkotimi është më i dobishëm tek ai, atëherë ai përbën rrugën më të ligjshme ndaj këtij personi.

Ai besimtar thirrës, i cili ndjek rrugën e afrimit dhe të inkurajimit ndaj individit që meriton bojkotimin; ai ka gabuar dhe është treguar neglizhent, ndërsa ai

besimtar thirrës, i cili ndjek rrugën e bojkotimit ndaj atij që meriton butësinë dhe afrimin, është sjellë në mënyrë të ashpër dhe bëhet shkak që i thirruri të largohet.

Shejhul Islam Ibn Tejmijeh në lidhje me këtë thotë: *“Bojkotimi ndryshon sipas gjendjes së personave që bëjnë bojkot, në varësi të forcës ose të dobësisë së tyre, si dhe nga fakti nëse janë shumë apo pak, sepse qëllimi i bojkotimit është qortimi i personit që i bëhet bojkot dhe edukimi i tij dhe po ashtu ka për qëllim që njerëzit e thjeshtë të largohen nga ai veprim i gabuar. Nëse bojkotimi ndaj personit ka dobi dhe shpie në pakësimin e sherrit, apo në largimin e tij nga sherri, atëherë bojkotimi është i lejuar. Nga ana tjetër, në qoftë se atij që i bëhet bojkot dhe të tjerët nuk ndikohen prej bojkotimit, por përkundrazi sherri shtohet, ndërkohë që bojkotuesi është i dobët, duke bërë që dëmi të jetë më i madh se dobia atëherë bojkotimi nuk lejohet. Për këtë arsye, butësia me disa njerëz është më e dobishme se sa bojkotimi i tyre, ndërsa bojkotimi i*

## *Këshillë*

*disa njerëzve është më i mirë se sa butësia me ta, prandaj edhe Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, me disa prej njerëzve sillej butë, ndërsa disa të tjerëve u bënte bojkot.*

*Kjo temë është e ngjashme me çështjen e armikut, me të cilin në disa raste është e ligjshme lufta, në disa raste armëpushimi dhe paqja, e në raste të tjera marrja e xhizjes, të gjitha këto, në bazë të dobisë dhe në varësi të situatës. Përgjigjet e dijetarëve të mëdhenj, si imam Ahmedi dhe të tjerë, në lidhje me këtë çështje bazohen pikërisht në këtë parim”. (“Mexhmuul Fetaua”: 28/206).*

Gjithashtu ai, Allahu e mëshiroftë, kur sqaron gabimin e atyre që përgjithësojnë përdorimin e bojkotit, apo sjelljes së butë, pa marrë parasysh rregullin e lartpërmendur, thotë:

*“Disa njerëz e përgjithësuan bojkotimin dhe e përdorën atë, në çështje që nuk ishin të urdhëruar ta bënin, as nuk e kishin detyrë dhe as nuk ishte e pëlqyer, e ndoshta me atë që bënë lanë pas dore*

*detyra dhe punë të pëlqyeshme dhe bënë gjëra të ndaluara. Ndërsa disa besimtarë të tjerë e lanë tërësisht pas dore parimin e bojkotit, duke mos e bojkotuar atë që e meritonte, si pasojë e bidateve dhe e punëve të këqija” (“Mexhmuul Fetaua”: 28/213).*

**E** gjashta: Bojkotimi lejohet për tri qëllime fetare; për të cilat kanë treguar argumentet si dhe e kanë vendosur dijetarët e mëdhenj.

**Qëllimi i parë: Bojkotimi i cili është në dobi të personit i cili bën bojkotin.** Muslimani ka të drejtë që të bojkotojë çdokënd që e dëmton nëse shoqërohet me të, si p.sh: pasuesit e bidatit ose gjynahqarët, të cilët e dëmtojnë fenë e tij nëse ai shoqërohet me ta.

E për këtë çështje na tregon hadithi i Ebu Musa el-Eshariut, i cili gjendet në dy Sahihet se Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

## *Këshillë*

*“Shembulli i shokut të mirë dhe i shokut të keq është si shembulli i atij që mban erë të mirë dhe farkëtarit; njeriu i cili mban erën e mirë, ose prej tij do të merrje nga kjo erë e mirë, ose së paku prej tij do të nuhasësh erë të mirë, ndërsa farkëtari ose do të t’i djegë rrobat ose së paku prej tij do të nuhasësh erë të keqe”* (Transmeton: Buhariu me numër: 3101 dhe Muslimi me numër: 2628).

Në këtë hadith kemi udhëzimin e Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, në shoqërimin e njerëzve të mirë, se si përfiton prej tyre dhe po ashtu, si të kemi kujdes nga shoqërimi me njerëz të këqinj, duke qenë se si pasojë e shoqërimit me ta dëmtohet feja jote.

Në këtë hadith kemi udhëzimin e Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, që të shoqërohemi me njerëzit e mirë e të devotshëm, sepse mirësia e tyre u përcillet edhe shoqëruesve të tij, si dhe të mos shoqërohemi me të këqijtë sepse shoqërimi me ta lë tek ty pasoja dëmtuese në fe.

Sipas këtij hadithi del në pah lejimi i bojkotimit të individit, nga i cili druhen se na dëmton fenë nëse shoqëroheni me të ndërsa individët që nuk druhen nga dëmtimi i fesë së tyre nëse shoqërohen me ta; sikurse mund të jenë p.sh., dijetarët, prej të cilëve shpresohet që të tjerët të përfitojnë prej diturisë së tyre, pa e dëmtuar dijetarin në fenë e tij, kësaj kategorie individësh nuk u lejohej që të bëjnë bojkotim, por përkundrazi, u lejohej të shoqërohen me persona të tillë, në mënyrë që të ndikojnë tek ta, nëse dobia është e konsiderueshme.

**Qëllimi i dytë: Bojkotimi në dobi të umetit:** Lejohej bojkotimi ndaj personit, nëse umeti përfiton dobi nëpërmjet bojkotimit të tij; si p.sh., të bojkotosh disa prej atyre që kundërshtojnë sunetin në mënyrë që të tjerët të marrin mësim prej bojkotit të tij e mos të veprojnë si ai.

Si shembull prej sunetit mbi këtë çështje na vjen në ndihmë transmetimi i Buhariut dhe Muslimit të hadithit të Ebu Hurejrës, Allahu qoftë i kënaqur prej tij:

*“Se të Dërguarit të Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të) i sillnin xhenaze që kishte pasur borxhe dhe ai pyeste: **A ka lënë pasuri?** Nëse i tregonin se ka lënë pasuri për të shlyer borxhin, ai ia falte namazin, në të kundërt thoshte: **“Faljani namazin shokut tuaj”**. (Buhariu: 5371 dhe Muslimi: 1619).*

Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, nuk ia falte namazin e xhenazes megjithëse ai mund të ishte besimtar i kapur pas fesë, por nuk kishte lënë se me çfarë të lante borxhin në mënyrë që të tjerët të merrnin mësim dhe mos të vepronin si ai, siç dhe e ka shtjelluar shejhul Islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë) ku thotë: *“Ai që i bën gjynahet haptas, megjithëse kanë besimin, si p.sh., individët që bëjnë gjynahe të mëdha, këtyre duhet patjetër që t’ua falin xhenazen disa prej muslimanëve, por nëse ndokush nuk ua fal namazin e xhenazes në mënyrë që të tjerët që janë si ai të marrin mësim, sikurse ka vepruar Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, i cili nuk ua ka falur namazin atyre që*



*kanë vrarë veten, apo atyre që kanë qenë vrasës, borxhlinjve që nuk kanë lënë pasuri për të larë borxhin dhe po ashtu shumë prej selefëve nuk e kanë falur namazin e bidatçinjve, kjo vepër prej tij është sunet i mirë” (“Mexhmuul Fetaua”: 24/286).*

**Qëllimi i tretë: Bojkoti në dobi të atij që i bëhet bojkot (personit që ka kundërshtuar sunetin).**

Lejohet bojkotimi i personave që kanë kundërshtuar sunetin, të tillë si bidatçinjtë ose ata që bëjnë gjynahe, nëse në bojkotin që u bëhet ka dobi për ta, në mënyrë që të largohen nga kryerja e asaj vepre dhe të pendohen për atë që kanë bërë.

Për këtë lloj bojkoti dëshmon edhe ngjarja e Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, kur i bëri bojkot Ka’b ibn Malikit dhe dy shokëve të tij, deri sa ata u penduan për atë që vepruan dhe kjo ngjarje është transmetuar nga dy Sahihët nga hadithi i Ka’b ibn Malikut. (Trasmenton: Buhariu: 6255 dhe Muslimi: 2769).

Shembuj të tillë ka plot në Sunetin e Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, po ashtu edhe prej punëve të selefëve të parë ku janë bojkotuar ata që e kanë kundërshtuar sunetin, në mënyrë që të marrin mësim dhe të edukohen.

Ky lloj bojkotimi, bojkoti për të mirën e personit që bojkotohet, megjithëse në thelb të tij është i lejuar, duhet të ketë parasysh rregullat që kanë të bëjnë me vërtetësinë e tij dhe zbatimin e tij tek një person i caktuar, prej atyre që e kanë kundërshtuar sunetin, gjë të cilën do ta sqarojmë në pikën e mëposhtme.

**E**shtata: Ai që e shikon bojkotimin e kundërshtarit tek qëllimi i tretë prej qëllimeve të bojkotit (i cili është: bojkotimi i kundërshtarit për të mirën dhe për përmirësimin e tij), duhet që të marrë parasysh rregullat fetare lidhur me këtë temë, për të cilat kanë folur dijetarët e me anë të së cilave mund të shohim

**qartësisht se kujt duhet t'i bëhet bojkot dhe kujt nuk duhet t'i bëhet bojkot prej kundërshtarëve.**

**Prej rregullave janë:**

**1- Rregulla që kanë të bëjnë me individin i cili bën bojkotin:**

Ai duhet që të jetë i fortë në karakter, në mënyrë që bojkoti i tij të ndikojë në edukimin e kundërshtarit, sepse nëse ai është i dobët, atëherë bojkoti nuk e kryen funksionin e tij; kjo ndodh nëse duke bërë bojkot merret si qëllim përmirësimi dhe edukimi i kundërshtarit, e nëse qëllimi i bojkotit është të ruhet prej tij, duke u druajtur nga fakti që shoqërimi me të do të ndikojë negativisht në fenë e tij, atëherë ai mund të bojkotojë çdokënd që e dëmton atë, sikurse e përmendëm edhe më sipër.

**2- Rregulla që kanë të bëjnë me personin të cilit i bëhet bojkot:**

Është i lejueshëm të bëhet bojkot nëse bojkoti që i bëhet një individit ka aq dobi sa ai të kthehet dhe të

## *Këshillë*

ndjekë rrugën e vërtetë; e nëse atij nuk i bën dobi kjo, por përkundrazi, ia shton atij largimin dhe inatin, bojkoti i tij nuk lejohet dhe kjo ka të bëjë me natyrën e disa personave që janë kokëfortë në karakter dhe të ashpër në sjellje dhe që nuk nënshtrohen, edhe nëse ai dëmtohet. Këtij individ nuk i bën dobi ndëshkimi dhe bojkotimi, por mund t'i bëjë dobi butësia në sjellje dhe afrimi e ndoshta, në mospërfitim të tij nga bojkoti mund të ndikojnë disa faktorë të jashtëm, si p.sh: të jetë person me pozitë ose person i pasur, apo person me gradë. Kësaj kategorie individësh, në shumicën e rasteve, nuk u bën dobi bojkotimi sepse ata mendojnë se nuk ia kanë nevojën individit që i bën bojkot nëse ai i bojkoton ata, për këtë arsye Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, i afronte dhe u fitonte zemrat atyre që konsideroheshin si pari në popujt e tyre dhe ishin njerëz me pozita të larta shoqërore, si Ebu Sufjani, Ujejnetu ibn Hisn, Ekreu ibn Habis etj.

Shejhul Islam Ibn Tejmije thotë: *“Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, disa i afronte dhe disa të tjerë i bojkotonte, sikurse veproji me tre persona, të cilët nuk morën pjesë në luftë, megjithëse ata ishin më të mirë se shumë prej tyre që ai i afronte dhe u përfitonte zemrat sepse këta të fundit ishin prijës dhe me pozita shoqërore në fiset e tyre”* (“**Mexhmuul Fetua**” 28/206).

### **3- Rregullat që kanë të bëjnë me llojin e kundërshtimit:**

Nuk ekziston ndonjë lloj kundërshtimi që të mund të thuhet se për këtë lloj bojkotimi vlen përherë, apo për një lloj tjetër, bojkotimi asnjëherë nuk mund të ketë vlerë, sikurse mendojnë disa se bojkot u bëhet bidatçinjve e jo atyre që bëjnë gjynahe, apo hexhër (bojkot) u bëhet atyre që bëjnë bidate që të nxjerrin nga Islami, ndërkohë që disa bidateve të tjera nuk u bëhet bojkot; ose bojkoti bëhet për gjynahet e mëdha e jo për të voglat, por përkundrazi bojkoti është për të gjitha llojet e gjynaheve, edhe nëse janë të vogla, nëse

konsiderohet prej personave të cilëve bojkotimi mund t'u bëjë dobi. E gjithë çështja kthehet në pyetjen se a i bën apo nuk i bën dobi bojkotimi, atij personi që ka kundërshtuar sunetin, pa marrë parasysh nëse kundërshtimi është i vogël apo i madh.

Duke u bazuar në këtë bojkot mund t'i bëhet një personit prej pasuesve të sunetit për ndonjë kundërshtim të vogël, sikurse veproi i Dërguari i Allahut, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, kur i bëri bojkot disa prej shokëve të tij në gjëra të vogla, si p.sh: moskthimi i selamit nga ai, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, Amar ibn Jasirit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, kur ky u parfumos me Za'feran<sup>1</sup>. (Transmeton: Ebu Davudi (4601) dhe e ka cilësuar si Hasen (të mirë) shejh Albani në librin “**Sahih Ebu Davud**”).

Gjithashtu, moskthimi i selamit nga ai, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ndaj shokut të tij, i

---

<sup>1</sup> Sh.p.: Lloj bime prej të cilës nxirret esencë parfumeshe.

cili kishte ndërtuar një kube, derisa ai e shembi atë. (Transmetoi: Ebu Davudi (5237) dhe e ka saktësuar hadithin shejh Albani në librin “**Sahih Ebu Davud**”).

Në të njëjtën kohë mund të mos bëhet bojkot ndaj disa personave, megjithëse kanë gabime të mëdha dhe që janë në gradë më të ulët krahasuar me ata që u bëhet bojkot. Shembull për këtë është afrimi që Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, i bënte Ekreu ibn Habis dhe Ujejnete ibn Hisn, si dhe afrimi që i bënte disa munafikëve si Abdullah ibn Ubej etj. E gjithë kjo bëhej duke parë dobinë, si dhe duke pasur parasysh rregulla të tjera që kanë të bëjnë me bojkotimin.

#### **4- Rregulla që kanë të bëjnë me kohën dhe vendin në të cilin ndodhin gabimet:**

Mes vendeve dhe kohërave në të cilat ndodhin gabimet dhe gjynahet ka dallim, po ashtu edhe nëse prania e tyre është më e madhe, në vende dhe në kohëra, në të cilat gabimet janë të pakta dhe vepruesit e tyre janë më të paktë. Nëse në ndonjë

vend apo kohë dominojnë pasuesit e sunetit, atëherë bojkotimi lejohet, duke pasur parasysh rregullat e tjera të bojkotimit; sepse ai i cili gabon është i dobët dhe me këtë bojkot ai disiplinohet, siç ka thënë Allahu në lidhje me Ka'b ibn Malik dhe shokët e tij:

حَتَّىٰ إِذَا ضَاقَتْ عَلَيْهِمُ الْأَرْضُ بِمَا رَحُبَتْ وَضَاقَتْ عَلَيْهِمْ أَنفُسُهُمْ وَظَنُّوا  
أَن لَّا مَلْجَأَ مِنَ اللَّهِ إِلَّا إِلَيْهِ

***“... atëherë kur toka, sado e gjerë, iu duk e ngushtë dhe shpirtrat iu shtrënguan, aq sa u bindën se nuk ka strehim tjetër përveç se tek Allahu ...”*** (Et-Teube: 118).

Shembull disiplinimi dhe korrektimi është rasti i Sabig ibn Aselit, i cili u bojkotua nga Umeri dhe umeti, sikurse është e njohur në histori. Mirëpo nëse në ndonjë vend apo kohë të caktuar dominimi është i të këqinjve dhe i pasuesve të së kotës, bojkotimi nuk lejohet, përveçse në rrethana të veçanta, sepse bojkotimi nuk e përmbush qëllimin e



tij për ndëshkim dhe edukim, por përkundrazi kjo mund të dëmtojë pasuesit e së vërtetës.

Shejhul Islam Ibn Tejmije thotë: *“Për këtë arsye, ekzistojnë dallime mes vendeve ku pasuesit e bidatit janë të shumtë, ashtu siç ishin pasuesit e Kaderit në Basra, astrologët në Horasan, apo shiizmi në Kufe dhe vendeve që nuk janë të tillë. Gjithashtu ka dallim midis bojkotit prej dijetarëve, të cilëve u dëgjohet fjala dhe bojkotit të bërë nga individë të tjerë. Kur njihen qëllimet e fesë ndiqet rruga më e shkurtër dhe më e dobishme që të çon drejt saj”* (“**Mexhmuul Fetua**”: 28/206-208).

#### **5- Rregulla që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e bojkotit:**

Kjo kohë duhet të jetë e përshtatur me gjendjen e njeriut që gabon dhe llojit të gjynahut që ka bërë; sepse ka disa prej njerëzve që edukohen me bojkotimin e një ose dy ditëve, një ose dy muajve, ndërkohë që ka prej tyre, për të cilët kërkohet më shumë, apo më pak kohë. Nëse prej bojkotimit

## Këshillë

arrihet qëllimi, atëherë bojkotimi duhet të ndërpritet sepse në rast të kundërt arrin në gjendjen që e humbet shpresën, ashtu sikurse bojkoti nuk sjell dobi në rast se bëhet në masë të paktë.

Ibn Kajimi, duke përmendur dobitë që përfitohen nga bojkotimi i Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, Ka'b ibn Malikut dhe shokëve të tij, thotë: *“Në këtë çështje ka argument se bojkotimi bëhet prej prijësit, dijetarit dhe personit me pozitë ndaj atyre që e meritojnë qortimin. Bojkoti për ta është si ilaçi, në një mënyrë të tillë që nuk e dobëson arritjen e shërimit, si dhe nuk shtohet në sasinë dhe mënyrën e përdorimit për arsye se do shkaktonte shkatërrimin e personit, sepse qëllimi është të edukohet dhe jo të shkatërrohet”* (“**Zadul Mead**”: 3/20).

**F**teta: Kundërpërgjigja dhe refuzimi që i bëhet kundërshtarit duhet të jetë me qëllimin që ta këshillosh atë, si dhe të mbrosh umetin prej gabimit të tij.

Kjo pikë përbën një prej bazave më të mëdha të Ehli Sunetit, si dhe prej xhihadit më të lartë, por në zbatim të saj duhet që të merren parasysh rregullat fetare dhe kushtet nëpërmjet të cilave të arrihet qëllimi fetar.

Prej këtyre rregullave:

- 1- Ky bojkot të jetë i sinqertë dhe me nijet të pastër për të ndihmuar të vërtetën, kjo gjë të jetë parësore.**

Prej elementëve që tregojnë se ekziston sinqeritet në atë bojkot është që të duash udhëzimin e kundërshtarit dhe kthimin e tij tek e vërteta, si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët e mënyrat që të shpien në afrimin e zemrës së tij, e jo në largimin e tij. Gjithashtu ta shoqërosh këtë, duke iu lutur

Allahut të Lartësuar që ta udhëzojë atë, sidomos nëse ai person është prej atyre besimtarëve që e pasojnë sunetin. Pejgamberi, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ka bërë dua që të udhëzohen disa prej pabesimtarëve, e si mund të qëndrojnë çështja nëse bëhet fjalë për dikë që është musliman, njësues i Allahut?!

## **2- Kundërpërgjigja të vijë nga një person i ditur, i cili është i thelluar në dituri.**

Ky njeri i ditur, i cili i njeh hollësisht detajet, këndvështrimet dhe shtjellimet e çështjes për të cilën bëhet kundërpërgjigja, nga aspekti i argumenteve fetare dhe i thënieve të dijetarëve, është në gjendje të përcaktojë masën reale të gabimit që ka bërë kundërshtari, të kuptojë se ku qëndron keqkuptimi i kundërshtarit dhe është në dijeni të asaj se çfarë kanë thënë dijetarët lidhur me këtë keqkuptim, të përfitojë prej fjalëve të tyre mbi këtë temë. Ai individ që merr përsipër t'i kundërpërgjigjet gabuesit duhet të ketë

argumentim të fortë mbi sqarimin e së vërtetës dhe largimin e keqkuptimeve, të jetë i saktë në fjalët që përdor, në mënyrë që fjalët e tij të mos keqkuptohen sepse nëse individ i që kërkon të merret me këtë aspekt nuk i posedon këto kushte gjatë kundërpërgjigjes së tij, atëherë dëmi do të jetë i madh.

**3- Të marrë në konsideratë gjatë kundërpërgjigjes së tij dallimet që ekzistojnë ndërmjet gabimtarëve në atë që kanë gabuar.**

Po ashtu, duhet të marrë në konsideratë pozitën që mund të ketë gabuesi, qoftë në aspektin fetar, apo në atë material (për çështje dynjaje). Gjithashtu të bëjë dallimin mes qëllimeve që shërbenin si nxitje në gabimin e tij, mos vallë i erdhi nga padituria, apo nga plotësimi i tekave në mënyrë të vazhdueshme dhe bidatit ose ka gabuar në të shprehur, është nxituar në fjalë (lapsus), është ndikuar nga ndonjë dijetar, nga banorët e vendit ku ai jeton, nga ndonjë shpjegim i gabuar dhe keqinterpretim, apo nga

shumë faktorë të tjerë që mund të shpien në gabime fetare.

Ai individ që nuk i merr në konsideratë këto dallime dhe nuk i ka parasysh gjatë kundërpërgjigjes, mund të bjerë në ekstremin e teprimit ose të neglizhimit, gjë e cila e bën që gabuesi të mos përfitojë nga fjalët e tij ose përfitimi i tij të jetë i paktë.

**4- Të marrë në konsideratë arritjen e asaj që është më e dobishme nga ana fetare.**

Nëse pas kundërpërgjigjes së tij shkaktohet dëm më i madh se sa dëmi i gabimit që ka bërë kundërshtari, atëherë nuk lejohet që t'i kundërpërgjigjesh; sepse nuk mund të largojmë një të keqe dhe në vend të saj të sjellim një të keqe akoma më të madhe se ajo që larguam.

Shejhul Islam Ibn Tejmije thotë: *“Nuk lejohet që të keqen e vogël ta largojmë me një të keqe më të madhe, e as të largojmë dëmin e vogël duke shkaktuar një dëm që është më i madh se ai; sepse*

*feja ka ardhur me qëllimin që të bëjë të mundur arritjen e të mirave dhe përsosmërinë e tyre, si dhe të bëjë të mundur shmangien e së keqes ose ta pakësojë atë, sipas mundësisë. Ajo që kërkohet është e mira më e madhe ndërmjet të mirave, nëse nuk është e mundur që t'i arrish të gjitha, si dhe largimin e të keqes më të madhe mes të këqijave, nëse nuk është i mundur largimi i të gjitha të këqijave” (“El-Mesail el-Mardinijeh”: 63-64).*

**5- Duhet që përhapja e kundërpërgjigjes të jetë në përputhje me përmasat e përhapjes së gabimit.**

Nëse gabimi gjendet në një vend ose në një shoqëri të caktuar, kundërpërgjigja nuk duhet që të shpërndahet, qoftë në formë të shkruar, në formë auditive, apo në forma të tjera, në një vend tjetër ose në një shoqëri tjetër që nuk ka dëgjuar për gabimin; nëse kundërpërgjigja shpërndahet, edhe gabimi do të përhapet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, në këtë mënyrë njerëzit mund ta dëgjojnë gabimin dhe u mbetet atyre diçka prej

gabimit, nëse nuk binden me kundërpërgjigjen. Është më mirë që njerëzit të qëndrojnë në qetësi dhe në mirësi duke mos dëgjuar për gabimin, se sa ta dëgjojnë atë dhe më pas të dëgjojnë kundërpërgjigjen e tij. Të parët tanë të mirë e merrnin në konsideratë diçka të tillë në kundërpërgjigjet e tyre. Shumë prej këtyre dijetarëve, në librat dhe kundërpërgjigjet që shkruanin e argumentonin të vërtetën, pa e përmendur fare gabimin dhe kjo tregon për nivelin e diturisë që kishin, gjë e cila mungon tek disa dijetarë të kohëve të fundit.

Ajo që u theksua më sipër lidhur me shpërndarjen e kundërpërgjigjes në atë vend që gabimi nuk është përhapur, theksohet edhe në lidhje me atë shoqëri që nuk e ka dëgjuar diçka të tillë edhe nëse ai gabim mund të gjendet në shtetin e tyre. Kjo është arsyeja që kundërpërgjigjet nuk duhet që të përhapen mes njerëzve të thjeshtë, të cilët nuk kanë dëgjuar për të, qoftë nëpërmjet librave ose kasetave. Sa e sa fitne u janë paraqitur njerëzve të thjeshtë dhe si



pasojë kanë rënë në dyshime dhe po ashtu janë hutuar rreth bazave të fesë, si pasojë e asaj që kanë parë tek kundërpërgjigjet, gjëra që mendja e tyre nuk mund t'i perceptonte. Individët që angazhohen në përhapjen e këtyre gjërave mes njerëzve të thjeshtë ta kenë frikë Allahun, si dhe të kenë kujdes mos të bëhen shkaktarë që të sprovonjë njerëzit në fenë e Allahut.

Prej gjërave më të çuditshme që kam dëgjuar lidhur me këtë temë është se disa prej nxënësve të dijes janë angazhuar duke u shpërndarë libra të tillë disa besimtarëve që sapo kanë pranuar Islamin, të cilët nuk kanë në Islam më shumë se disa ditë, apo disa muaj, ndërsa ata i kanë këshilluar që t'i lexojnë këto libra! Pasha Allahun! Sa të çuditshëm janë këta persona në atë që veprojnë!!!

## **6- Kundërpërgjigja ndaj kundërshtarit është prej farzeve kifaje<sup>2</sup>.**

Nëse dikush prej dijetarëve e kryen këtë obligim, arrihet me të qëllimi fetar ndaj gabuesit, si dhe i tërhiqet vëmendja umetit prej atij gabimi, dijetarët e tjerë nuk janë të obliguar që edhe ata të bëjnë diçka të tillë, siç është e njohur tek dijetarët për të gjitha çështjet që janë farz kifaje.

**Nga gabimet e përhapura është:** Nëse publikohet një kundërpërgjigje e një dijetari ndaj një gabuesi, apo del ndonjë fetva që tërheq vërejtjen për ndonjë gabim, shumë prej nxënësve që pretendojnë se pasojnë Sunetin, u kërkojnë dijetarëve apo nxënësve të tjerë të dijës të shfaqin qëndrimin pro apo kundër që kanë ndaj kundërpërgjigjes apo ndaj fetvasë, derisa ka arritur situata që të kërkohet prej disa nxënësve të vegjël se çfarë qëndrimi kanë, apo edhe prej njerëzve të thjeshtë, e më pas në bazë të

---

<sup>2</sup> Sh.p.: Farz kifaje - obligim kolektiv, që do të thotë, nëse një grup personash e kryejnë atë, hiqet obligimi për të tjerët.

përgjigjes që u jepet ata lidhin dashurinë apo armiqësinë, e si pasojë e gjithë kësaj vjen bojkotimi i njerëzve, ku arrin puna që disa prej nxënësve të bojkotojnë disa prej shujhëve të tyre, prej të cilëve kanë përfituar nga dija e tyre dhe besimi i tyre i pastër për vite me radhë. Ndodh që mund të përhapet fitneja nëpër shtëpitë e njerëzve, ku shikon se si vëllai bojkoton të vëllanë, apo fëmija ftohet me prindërit e tij, e ndoshta mund të arrijë çështja që burri të ndajë gruan e tij duke bërë që të çoroditen fëmijët.

E nëse i hedh një sy shoqërisë, e shikon atë të ndarë në dy ose më shumë grupe, ku çdo grup fajëson grupin tjetër, lëshon lumë akuzash dhe u obligon të tjerëve që ta bojkotojnë atë grup. E gjithë kjo ndodh tek individët që pretendojnë se janë pasues të Sunetit, ku asnjë grup nuk mund ta akuzojë grupin tjetër në besimin që ka, e as në metodologjinë që ndjekin, përpara se të ndodhte kjo mosmarrëveshje. E gjithë kjo e ka burimin tek injoranca e madhe që kanë mbi sunetin dhe rregullat e qortimit tek Ehli

Suneti ose ata pasojnë tekat (epshet) e tyre. E lusim Allahun e Lartësuar që të na ruajë e të na shpëtojë prej gjërave të tilla.

**E**nënta: Dijetarët e sunetit që janë të njohur për besimin e tyre të pastër dhe për mundin që kanë dhënë në përhapjen e sunetit dhe të triumfit të tij, duhet që të ruhet pozita e tyre dhe t'u njihet vlera që kanë. Kurrsesi nuk lejohet që të përfliten, apo të konsiderohen si bidatçinj, apo të akuzohen se pasojnë tekat e tyre, apo se janë nervozë, vetëm për shkak të ndonjë gabimi që mund të ndodhë prej tyre, si pasojë e ixhtihadit (mundit që japin në arritjen e së vërtetës).

Shejhul Islam Ibn Tejmije thotë: *“Nuk ka dyshim se gabimi që bëhet në çështjet delikate, e të imëta të dijës konsiderohen prej gabimeve që i falen umetit, edhe nëse kanë të bëjnë me çështjet e besimit. Sikur të mos ndodhte diçka e tillë, shumë prej njerëzve me vlera të umetit do të shkatërroheshin. Përderisa Allahu e fal atë person, i cili nuk e di se alkooli është*

*i ndaluar, nëse është rritur në një vend ku sundon injoranca, edhe pse ai nuk e ka kërkuar dijen, është më parësore që t'i falet gabimi i njeriut me vlera, i cili është treguar i zellshëm në kërkimin e dijes, sipas mundësive që ka pasur në kohën e tij dhe në vendin e tij, për sa kohë që qëllimi i tij është i pastër, me qëllim për të pasuar të dërguarin e Allahut sipas mundësive. Ky individ ka më përparësi që t'i pranohen punët e mira, të shpërblehet për mundin e tij dhe të mos merret në llogari për gabimet e tij, dhe e gjithë kjo, në përmbushje të fjalës së Tij ku thotë: **“Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë apo veprojmë pa qëllim!”** El-Bekare 286 (“**Mexhmuul Fetaua**”: 20/165).*

*Gjithashtu ai thotë: “Kjo është ajo çfarë kanë thënë dijetarët e mëdhenj selefij si Ebu Hanifeja, Shafiu, Theuri, Davud ibn Ali dhe të tjerë. Ata nuk e konsideronin gjynahqar një njeri që jepte mundin e tij për të kuptuar të vërtetën, por gabonte, qoftë në ndonjë nga çështjet bazë ose dytësore, siç e ka përmendur këtë prej tyre Ibn Hazmi dhe të tjerët.*

*Ata thonë: “Ky përfundim është ajo që njihet prej sahabëve dhe tabi’inëve, si dhe prej dijetarëve të mëdhenj të fesë, se ata nuk nxirrnin askënd prej Islamit, e as nuk e konsideronin gjynahqar atë që gabonte, pasi jepte mundin e tij për të vërtetën, qoftë ky gabim në çështje themelore ose dytësore të fesë. Gjithashtu kanë thënë se: "ndarja e çështjeve fetare në çështje themelore dhe dytësore<sup>3</sup> është ndarje e formuluar nga pasuesit e bidatit, si apologjetët, mu'tezilitë, xhehmijtë, e kushdo që pason rrugën e tyre” (“**Mexhmuul Fetaua**” 19/207).*

Kjo nuk do të thotë që të mos e këshillojmë dijetarin nëse gabon, përkundrazi, këshillimi i tij përbën obligimin që kemi ndaj tij, madje është pjesë e mirësjelljes dhe e dashamirësisë që kemi ndaj tij, por nga ana tjetër këshilla duhet që të jepet me butësi dhe në mënyrë që t’i përshtatet pozitës së tij që ka në dituri.

---

<sup>3</sup> Sh.p.: D.m.th. të arsyetohen në çështjet dytësore e mos të arsyetohen në çështjet themelore kur gabojnë.

Më pas, nëse ai nuk i përsërit më gabimet e tij dhe e përmirëson sjelljen, kjo është më e mira, rrjedhimisht, pas kësaj, nuk lejohet më që të përflitet e as të qortohet për gabimet e tij, po ashtu, nuk duhet që të vihet në dyshim sinqeriteti i kthimit të tij në rrugë të drejtë.

E nëse ai nuk ndërgjegjësohet për gabimet, si pasojë e ndonjë paqartësie, apo e ndonjë keqinterpretimi që ndikon tek ai që të mos arrijë tek e vërteta, duhet që gabimi i bërë rishtazi të vlerësohet:

- a-** Nëse gabimi ka të bëjë vetëm me të personalisht, atëherë obligimi që kemi ndaj tij kryhet me këshillim në mënyrë të veçuar nga të tjerët.
- b-** Nëse gabimi i tij përhapet mes njerëzve, atëherë u tërhiqet vërejtja njerëzve që të ruhen nga ky gabim, por duke e ruajtur pozitën që ka ky dijetar.

Këtu duhet që të tërheqim vërejtjen për dy parime kryesore të mëdha:

- **E para: Duhet që nijeti të jetë i pastër vetëm për të arritur të vërtetën dhe larg çdo nijeti për qëllime të tjera.**
- **E dyta: Duhet që të ruajmë pozitën që kanë dijetarët.**

Këto dy baza nuk bien ndesh me njëra-tjetrën tek pasuesit e sunetit dhe po ashtu, nuk i jepet përparësi njëres më shumë se tjetres.

T'i duam dijetarët dhe t'i njohim vlerat e tyre, nuk do të thotë që të heshtim ndaj gabimeve që bëjnë, apo të mos u tërheqim vërejtje njerëzve për gabimet e tyre, si dhe të jemi të sigurtë se duam të vërtetën. Duke tërhequr vërejtje për gabimet që ka bërë dijetari, nuk do të thotë që t'i përgojmë ata, apo t'i nënvlerësojmë, përkundrazi mundësojmë bashkim ndërmjet këtyre parimeve, nëse Allahu jep sukses për një gjë të tillë.



Ai individ që e njeh rrugën e dijetarëve në tërheqjen e vërejtjes ndaj gabimeve të njëri-tjetrit, pa e cënuar pozitën e individit konkret, arrin të kuptojë të vërtetën e kësaj çështjeje. Shembujt rreth kësaj teme janë të shumtë në fjalët e dijetarëve.

**E**dhjeta: Pasuesit e bidatit, të cilët e kanë kundërshtuar besimin e Ehli Sunetit dhe metodologjinë e tyre mbi mënyrën e argumentimit, edukimit, mësimdhënies, thirrjes tek Allahu, të cilët kanë pasuar tekat, duke mos ndjekur dijetarët e Ehli Sunetit, por përkundrazi duke i ofenduar ata, i përgojnë, madje mendojnë se janë më të mirë se ata; këta janë bidatçinj të humbur që duhen luftuar e duhet t'u tërhiqet vërejtja ndjekësve të tyre, për rrugën e keqe që ata ndjekin, mbi largimin dhe devijimin që kanë prej sunetit.

Dyshimeve të tyre duhet t'u kundërpërgjigjemi dhe t'i trajtojmë si bidatçinj në çdo kohë dhe në çdo situatë; gjithashtu kjo nuk na ndalon që t'i thërrasim ata drejt së vërtetës dhe po ashtu, të dialogojmë

me ta nëpërmjet dijetarëve, duke përdorur mënyrën më të mirë, nëse kjo do të ndikonte në kthimin e tyre tek Suneti.

Duhet pasur kujdes që mos të përziësh mes dijetarëve të Ehli Sunetit dhe mënyrës se si duhet të sillësh me ta, edhe nëse kanë gabime, duke ua ruajtur pozitën që u takon, e duke ua njohur vlerat që kanë, sikurse e theksuam edhe më sipër. Pra, ka dallim mes tyre dhe mes dijetarëve që pasojnë bidatin, me të cilët e ke për detyrë që mos të bashkëpunosh me ta, t'i bojkotosh, si dhe tu tërheqësh vërejtjen të tjerëve prej tyre.

Ky dallim bëhet sepse gabimi që ndodh nga dijetarët e Ehli Sunetit ndodh përgjatë mundit që tregojnë në kërkimin e së vërtetës, duke ndjekur rrugën e saktë në mënyrën e argumentimit, ndërsa gabimi që shfaqet nga pasuesit e bidatit është si pasojë e epsheve dhe mendimeve të devijuara dhe po ashtu si pasojë e mosndjekjes së rrugës së saktë

në argumentim. Ekziston një dallim i madh ndërmjet dy gjendjeve.

Ky është dallimi i madh midis pasuesve të sunetit dhe pasuesve të bidatit. Në këtë mënyrë, tek personi mendjemprehtë bëhet i qartë shkaku, i cili i bën dijetarët e mëdhenj që të mos i konsiderojnë bidatçinj disa prej dijetarëve të sunetit, të cilët janë pajtuar në disa pjesë të mendimeve, apo të thënieve me pasuesit e bidatit.

**E njëmbëdhjeta:** Po e mbyll këtë këshillë me disa udhëzime të mira, të vyera dhe të dobishme, të cilat i vlerësoj si të arsyeshme dhe se besimtari që i vë në zbatim arrin shpërblim të madh, sevape dhe grada të larta tek Allahu.

U bëj thirrje vëllezërve të mi që të punojnë me to dhe t'i kenë parasysh, sidomos në këtë kohë, në të cilën janë shtuar fitnet, kanë sunduar tekat dhe është përhapur injoranca, me përjashtim të atyre që Allahu i ka mëshiruar dhe i ka udhëzuar.

- 1- Dije o vëlla i sunetit, se nëse ti je vërtetë pasues i sunetit, ty nuk do të të dëmtojnë kurthet që banorët e tokës thurin ndaj teje dhe po ashtu, ty nuk mund të të nxjerrin prej sunetit akuzat që të bëjnë duke të cilësuar si pasues të bidatit.

Edhe nëse do ishe i humbur dhe i devijuar, Allahu të ruajtë nga diçka e tillë, nuk do të të sillte ty ndonjë dobi tek Allahu lavdërimi i njerëzve dhe fjalët e tyre që të të cilësojnë si pasues i sunetit, po ashtu edhe lëvdatat me epitetet e gënjeshtërtat që t'i atribuojnë në mënyrë të pamërituar, për sa kohë që Allahu e di prej brendësisë tënde atë që në të vërtetë ti di për veten tënde; ndaj ruaju nga mashtrimi i vetvetes. Të mjafton si përkujtim në këtë rast këshilla e Pejgamberit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, që i bëri Ibn Abasit<sup>4</sup>.(Transmeton Tirmidhiu me numër: 2516 dhe imam Ahmedi me numër: 2669).

---

<sup>4</sup> Sh.p.: Autori ka për qëllim hadithin e Ibn Abasit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ku thotë: Isha një ditë pas të dërguarit të

Dhe hadithin që tregon tre grupet e njerëzve, me të cilët do të ndizet zjarri Ditën e Gjykimit, Allahu më ruajtë mua dhe ty prej tij<sup>5</sup>. (Transmeton imam Muslimi me numër: 1905).

---

Allahut , paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, dhe më tha: *"O djalosh! Unë do të të mësojë disa fjalë: bindju Allahut në mënyrë që Allahu të të ruajë ty, bindju Allahut që të të gjendet pranë, nëse kërkon diçka kërkoje prej Allahut, e nëse kërkon ndihmë kërkoje prej Allahut. Dhe dije se nëse umeti do të mblidhet për të bërë dobi ty, nuk do kenë mundësi të të bëjnë dobi më shumë se ajo që e ka caktuar Allahu, e nëse mblidhen për të të shkaktuar dëm ty, nuk do të dëmtojnë vetëm aq sa Allahu e ka caktuar. Lapsat janë ngritur dhe fletushkat janë tharë"*. Hadithin e ka saktësuar imam Albani, Allahu e mëshiroftë, në **"Xhamiu Sagir"** me numër: 13917.

<sup>5</sup> Ka për qëllim hadithin e Ebu Hurejrës, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ku thotë: Kam dëgjuar të dërguarin e Allahut, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, duke thënë: *"Njeriu i parë që do të gjykohet Ditën e Gjykimit do të jetë ai i cili ka rënë dëshmor në luftë. Do të thirret dhe do t'i tregohen mirësitë e Allahut ndaj tij dhe ai do t'i pranojë, do t'i thuhet atij: Çfarë veproje me to? Do të thotë: Kam luftuar në rrugën Tënde derisa rashë dëshmor. Do t'i thuhet: Gënjën, ti ke luftuar për të të thënë njerëzit që je trim dhe ashtu thanë. Më pas urdhëron që ta tërheqin zvarrë me fytyrë dhe hidhet në zjarr. Dhe personi i cili mësoi diturinë e ua mësoi atë të tjerëve si dhe lexoi Kur'anin. Do të thirret dhe do t'i tregohen mirësitë e*

2- Dije se dijetarët e mëdhenj të sunetit arritën në gradat e larta në fe, me ndihmën që Allahu u dha, me durim dhe me bindje të thellë. Allahu i Lartësuar thotë:

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أُمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا وَكَانُوا بِآيَاتِنَا

يُوقِنُونَ ﴿٦١﴾

***“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të***

*Allahut ndaj tij dhe ai do t'i pranojë, do t'i thuhet atij: Çfarë veprime me to? Do të thotë: Mësova diturinë dhe ua mësova atë të tjerëve dhe e lexova Kur'anin për hirin Tënd! Do t'i thuhet atij: Gënjen, ti e mësove dijen që të të thonë të tjerët se je dijetar si dhe e lexove Kur'anin që të të thonë të tjerët se je lexues dhe ashtu thanë. Më pas urdhëron që ta tërheqin zvarrë me fytyrë dhe hidhet në zjarr. Si dhe personi të cilit i ka dhënë Allahu nga të gjitha llojet e pasurisë, do të thirret dhe do t'i tregohen mirësitë e Allahut ndaj tij dhe ai do t'i pranojë, do t'i thuhet atij: Çfarë veprime me to? Do të thotë: Nuk kam lënë rrugë që Ti ke pasur dëshirë që të shpenzohet në të, vetëm se kam shpenzuar në të për hirin Tënd. Do t'i thuhet atij: Gënjen, ti shpenzove që njerëzit të të thonë se je bujar, dhe ashtu thanë. Më pas urdhëron që ta tërheqin zvarrë me fytyrë dhe hidhet në zjarr”.*

***durueshëm dhe besonin bindshëm.***” (Es-Sexhde: 24).

Shejhul Islam Ibn Tejmije thotë: *“Me durim dhe bindje arrihet që të jesh prijës në fe”*.

**Bindja e thellë:** Është forca e dijes, e bazuar në argumentin e saktë, si dhe në kuptimin e pastër, e jo ashtu siç zgjodhën disa nxënës dije për vete që hiseja e tyre e diturisë të jetë thjesht pasimi i një dijetari, apo i ndonjë nxënësi të dijes, duke pretenduar se e vërteta është vetëm me të dhe se askush nuk e ka kuptuar sunetin më mirë se ai.

**Durimi:** Është vazhdueshmëria me këmbëngulje në kërkimin e dijes, duke e zbatuar atë, si dhe duke u angazhuar me të në orët e natës dhe të ditës, e të mos jesh si ata që u ka rënë vullneti nga kërkimi i dijes, kanë rënë në qetësi duke ia dorëzuar veten tekave, si pasojë e mungesës së vullnetit në kërkimin e dijes dhe në të punuarit me të.

- 3-** Dije se të konsiderosh njerëzit si mohues, bidatçinj, apo gjynahqarë është e drejtë vetëm e Allahut, prandaj ki kujdes dhe ruaju që të mos e konsiderosh ndonjë besimtar të dalë nga feja, apo nga suneti, apo ta quash gjynahqar, nëse ai nuk e meriton diçka të tillë, edhe nëse ai të nxjerr ty jashtë Islamit duke të konsideruar si mohues ose jashtë prej sunetit, apo të konsideron si gjynahqar. Pasuesit e sunetit nuk e trajtojnë padrejtësinë që u bëhet nga kundërshtari me padrejtësi sepse një gjë e tillë është nga shenjat e bidatçinjve.

Shejhul Islam Ibn Tejmije thotë: *“Hauarixhët i konsiderojnë si të dalë nga Islami pasuesit e Sunetit dhe të xhematit, gjithashtu edhe mu’tezilitë i konsiderojnë të dalë nga Islami kundërshtarët e tyre, po ashtu bëjnë edhe rafiditë. Atë person që nuk e nxjerrin nga Islami e konsiderojnë gjynahqar (mëkatar nëse nuk i pason ata), ndërsa Ehli Suneti pasojnë të vërtetën nga Zoti i tyre, të cilën ia zbriti*



*të Dërguarit, paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, dhe nuk i nxjerrin nga Islami kundërshtarët e tyre, ata janë më të diturit e njerëzve rreth së vërtetës dhe janë më të mëshirshmit me krijesat” (“Minhaxhu Suneh” 5/158).*

- 4- Mos e bojkoto atë që të bojkoton nga vëllezërit e tu, përveçse nëse bojkotimi i tij është i kërkuar (i ligjshëm), por jepi selam i pari dhe përfitoja zemrën, si dhe largoja dyshimin që ka ndaj teje, e nëse ai përsëri largohet pas kësaj, mos e beso bojkotin e tij me zemrën tënde, por në të njëjtën kohë mos e mundo veten tënde duke e ndjekur atë nga pas; sepse ti je i pastër nga gjynahu i ndërprerjes së lidhjes, ndërsa në këtë situatë ai është gjynahqari.
- 5- Përgojimi që njerëzit të bëjnë ose vjen në trajtën e ofendimit të personit tënd, ose të mveshin një të kotë, e cila bie ndesh me besimin e Ehli Sunetit. Nëse përflitesh në lidhje me individin tënd si p.sh., etiketimi:

injorant, i humbur, njeri që nuk kupton, etj., mos u përpiq që të kundërpërgjigjesh (me të njëjtën monedhë) sepse përndryshe do të biesh në lavdërimin e vetvetes, gjë e cila përbën humbjen e qartë.

***Është transmetuar se një person e nënçmoi njërin prej dijetarëve të mëdhenj të sunetit me një fjalë dhe ai ia ktheu: “Nuk është e largët ajo që the”.***

Pasuesit e bidatit i etiketonin dijetarët e sunetit me akuza të mëdha në personalitetin e tyre, por ata nuk ua vinin veshin dhe u kundërpërgjigjeshin vetëm në çështjet e fesë, në të cilat kishin gabuar dhe e këshillonin umetin, ndaj dhe ne kemi shëmbëlltyrën më të mirë tek ata.

Nëse të mveshin diçka prej fjalëve të kota si p.sh: filani thotë kështu ose ashtu, diçka që ti nuk e ke thënë, atëherë mohojë këtë nga vetja jote në mënyrë që mos të të mvishet diçka e kotë. Dijetarët, vazhdimisht mohojnë fjalë që u mvishen atyre dhe që realisht nuk i kanë thënë, e kjo nuk

konsiderohet lavdërim i vetes, por është këshillë ndaj umetit. Për këtë arsye ekziston një dallim ndërmjet kësaj situate dhe situatës së parë. Pasoji dhe kapu pas udhëzimit të dijetarëve në lidhje me këtë çështje, e mos u sill si disa injorantë, të cilët nëse përgojohen me diçka, e mbushin botën me lëvdata ndaj vetes, Allahu na ruajtë prej poshtërimit.

### **Së fundmi:**

- 6- Dije se njerëzit i çmojnë shumë ata që veprojnë**, nëse je prej pasuesve të sunetit, ti do të çmohesh çdo ditë e më shumë në të dhe me kalimin e ditëve ti do të jesh prijës në të. Allahu i Lartësuar thotë:

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أُمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا وَكَانُوا بِرَأْيَيْنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾

***“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm.”*** (Es-Sexhde: 24).

E nëse je prej bidatçinjve, çdo ditë ti çmohesh tek ata, me kalimin e ditëve ti do të bëhesh prijës në këtë (të keqe). Allahu i Lartësuar thotë:

قُلْ مَنْ كَانَ فِي الضَّلَالَةِ فَلْيَمْدُدْ لَهُ الرَّحْمَنُ مَدًّا حَتَّىٰ إِذَا رَأَوْا مَا يُوعَدُونَ إِمَّا الْعَذَابَ وَإِمَّا السَّاعَةَ فَسَيَعْلَمُونَ مَنْ هُوَ شَرٌّ مَّكَانًا وَأَضْعَفُ جُنْدًا

***“Thuaj (o Muhamed): “Atyre që janë të humbur, i Gjithëfuqishmi u lëntë edhe pak kohë”, në mënyrë që, kur të shohin atë që u është premtuar: ose dënimin (në këtë jetë) ose Orën (e Kiametit), atëherë do ta kuptojnë se kush ka pozitë më të keqe dhe përkrahës më të dobët.”*** (Merjem: 75).

Po ashtu ka thënë për Faraonin dhe për popullin e tij, pasi i cilësoi ata me mendjemadhësi në padrejtësi:

وَجَعَلْنَاهُمْ أَيْمَةً يَدْعُونَ إِلَى النَّارِ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ لَا يُنصَرُونَ

## *Shejkh Ibrahim Er-Ruhejli*

***“Ne i bëmë ata udhëheqës, që thërrisinin për në zjarr, ndërsa në Ditën e Kiametit askush nuk do t’i ndihmojë”*** (Kasas: 41).

Ndaj, sot zgjidh për veten tënde punët që dëshiron, në mënyrë që nesër të jesh prijës në to.

Allahu e di më së miri.

Paqja dhe nderimi i Allahut qoftë mbi robin dhe të Dërguarin e Tij Muhamed.

## Përmbajtja

<b>Parathënia e botimit të parë.....</b>	<b>3</b>
<b>Parathënie.....</b>	<b>6</b>
<b>E para:</b> Një nga bazat themelore të fesë është: Muslimani duhet që të përmirësojë veten e tij.....	<b>8</b>
<b>E dyta:</b> Duhet që të dijë se Ehli suneti janë me të vërtetë të denjë që ta paraqesin Islamin e plotë si në besim, ashtu edhe në sjellje.....	<b>10</b>
<b>E treta:</b> Prej qëllimeve të mëdha, për të cilën Islami ka nxitur është; udhëzimi i njerëzve në këtë fe.....	<b>13</b>
<b>E katërta:</b> Duhet që nxënësit e dijes të bëjnë dallimin midis mirësjelljes dhe lajkave.....	<b>15</b>
<b>E pesta:</b> Thirrësi gjatë thirrjes që u bën njerëzve ka dy metoda të lejuara: metoda e nxitjes dhe metoda e bojkotimit.....	<b>18</b>
<b>E gjashta:</b> Bojkotimi lejohet për tre arsye fetare.....	<b>21</b>
<b>E shtata:</b> Duhet që individi, i cili shikon në bojkotim të ketë parasysh rregullat fetare.....	<b>26</b>
<b>E teta:</b> Kundërpërgjigja ndaj kundërshtarit bëhet si këshillë ndaj tij dhe të ruhet umeti nga gabimi i tij.....	<b>35</b>

# *Shejkh Ibrahim Er-Ruhejli*

Rregulla fetare në lidhje me kundërpërgjigjen ndaj kundërshtarit.....**35**

1- Qëllimi të jetë i sinqertë.....**35**

2- Kundërpërgjigja bëhet nga një dijetar.....**36**

3- Të marrë në konsideratë gjatë kundërpërgjigjes së tij dallimet që ekzistojnë ndërmjet gabimtarëve në atë që kanë gabuar.....**37**

4- Të ketë parasysh me kundërpërgjigjen ndaj kundërshtarit që të arrijë dobinë fetare me atë kundërpërgjigje.....**38**

5- Të ketë parasysh që kundërpërgjigja të jetë në përmasat e gabimit.....**39**

6- Kundërpërgjigja ndaj kundërshtarit është prej farzeve kifaje.....**42**

**E nënta:** Dijetarët e Ehli Sunetit që njihet prej tyre besimi i pastër dhe mudi që kanë dhënë në ndihmën e sunetit duhet që t'u ruhet atyre vendi që kanë dhe të vlerësohet mudi i tyre.....**44**

**E dhjeta:** Pasuesit e bidatit, të cilët kanë kundërshtuar besimin e Ehli Sunetit dhe metodologjinë e tyre në argumentim,

## *Këshillë*

mësim, mësimdhënie dhe në thirrjen për tek Allahu si dhe pasojnë epshin dhe nuk morën shëmbëlltyrë dijetarët e sunetit, por përkundrazi i poshtërojnë dhe i nënvlerësojnë ato, këta emërtohen bidatçinj.....**49**

**E njëmbëdhjeta:** E mbyll këtë këshillë me disa udhëzime të vogla, të dobishme e të çmueshme që nëse zbatohen nga besimtari, do të përfitohet shpërblimin më i madh dhe grada më të larta tek Allahu .....**51**

**Përmbajtja** .....**62**